



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Komuna Rahovec - Opštine Orahovac**

**Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë**  
**Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu**

|                          |                                                                      |
|--------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| Data - Datum             | 26.04.2019                                                           |
| Referencë/a              | 08 nr. 22/2019                                                       |
| Për/Za/To :              | Enver Mahmuti nga Krusha e Madhe                                     |
| Zona Kadastrale:         | Krushë e Madhe                                                       |
| Përmes/ Prekp/Through:   | Afrim Oruqi - Drejtor<br>Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë |
| Nga/Od/From/             | Sektori për pronë                                                    |
| Subjekt/Subekat/Subject: | Vendim për uzuprim                                                   |

**Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec** duke vendosur sipas Kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, nr. 89/2019 më datë 02.04.2019, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar të pasurisë shtetërore, kundër të dyshuarit Enver Mahmuti nga Krusha e Madhe, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore ("Gazeta zyrtare e KASK", nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

**V E N D I M**

**I. VËRTETOHET** Se Enver Mahmuti nga Krusha e Madhe me ndërtimin e shtëpisë për banim dhe murit rrethues ka bërë zgjerimin e parcelës së vetë, nr. **449-0** në dëm të parcelës shtetërore nr. **390-0** Z. K. Krushë e Madhe, në emër të P.Sh. Kosovës K.K. Rahovec - Rrugët, duke bërë uzurpim arbitrar, në sipërfaqe prej **22 m<sup>2</sup>** shtëpi dhe muri rrethues prej **14 m<sup>2</sup>**, në sipërfaqe të përgjithshme **36 m<sup>2</sup>**, të pasqyruar në skicën e terrenit e hartuara nga eksperti i gjeodezisë.

**II.** Uzurpuesi arbitrar Enver Mahmuti nga Krusha e Madhe, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj, dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

**III.** Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

**IV.** Uzurpimi është kryer në vitet e pas luftës në Kosovë.

**V.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

## **A r s y e t i m**

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec duke vendosur sipas Kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, nr. 89/2019 më datë 02.04.2019, në çështjen administrative – uzurpim arbitrar në ngastrat shtetërore nr. **390-0** Z. K. Krushë e Madhe. Është vërtetuar se i përmenduri me ndërtimin e shtëpisë për banim dhe murit rrethues ka bërë zgjerimin e parcelës së vetë, nr. **449-0** në dëm të parcelës shtetërore të cekur më lart, ka bërë uzurpim arbitrar në pjesën e kësaj parcele në sipërfaqe të përgjithshme prej **36 m<sup>2</sup>**.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në vendin e ngjarjes, eksperti teknik - gjeodeti ka bërë matjen, incizimin e parcelave në fjalë, dhe ka hartuar skicën e terrenit, në të cilën pasqyrohet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

Personat zyrtar kanë tentuar që personi në fjalë të jep deklaratë lidhur me uzurpimin e pronës shtetërore, mirëpo personi në fjalë nuk ka qenë në shtëpi në atë moment kur është bërë matja dhe incizimi i parcelave në fjalë. Më datë 23.04.2019 personit i është bërë ftesë që të paraqitet në zyrën e kadastrit, mirëpo nuk është paraqitur dhe kjo drejtori është detyruar që të merr vendim për uzurpim.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelave në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri, ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi

shtetërore ( "Gazeta Zyrtare e KASK", 46/77 dhe 37/88 ), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitë të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për kadastrë, gjeodezi dhe pronë – Sektori i pronës K.K. Rahovec, më 26.04.2019

**08 nr.22/2019**

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimiit nëpërmjet kësaj drejtorie.

**Hartuesi**

Jur. i Diplomuar. Nazmi Krasniqi



**Drejtori**

Jur. Diplomuar. Afrim Oruqi

